



**Tiranë, më 22.11.2019**

**Lënda: Informacion për mosrealizimin e auditimit ligjor të detyrueshëm të fondeve të përfituara dhe të shpenzuara gjatë fushatës zgjedhore për zgjedhjet në Organet e Qeverisjes Vendore 2019, për Partinë G99.**

**Për: Komisionin Qëndror të Zgjedhjeve  
Rruga "Ibrahim Rugova", Nr. 4, Tiranë, Shqipëri**

Të nderuar zotërinj,

Me vendimin Komisionit Qëndror të Zgjedhjeve(KQZ) nr. 740, datë 31.05.2019 dhe kontratës së shërbimit në zbatim të tij, jam angazhuar në cilesinë e Ekspertit Kontabël të Autorizuar për misionin me objekt:

- Kryerjen e monitorimit të shpenzimeve të fushatës zgjedhore të partive politike dhe,
- Kryerjen e auditimit ligjor të detyrueshëm të fondeve të përfituara dhe të shpenzuara gjatë fushatës zgjedhore, për zgjedhjet në Organet e Qeverisjes Vendore të datës 30.06.2019, nga Partia G99.

Për përmbushjen e detyrimeve kontraktuale, menjëherë pas lidhjes së kontratës me KQZ-në, më datë 01.06.2019, kërkuam të vendosim komunikimin zyrtar me drejtuesit e Partinë G99, nëpërmjet dërgimit të letrave rekomande, në adresën e selisë së partisë siç ishte përshkruar në dokumentin e dërguar nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë drejtuar KQZ-së dhe në adresat që na dërgoi KQZ-ja në vazhdim, si dhe u telefonuam dhe dërguam e-maile për drejtuesin kryesor të partisë.

Megjithë përpjekjet tona, ne nuk mundëm të kontaktonim me personat përgjegjës të Partisë, për të marrë informacionin mbi aktivitetet, buxhetin e të ardhurave dhe të shpenzimeve, dokumentimin e transaksioneve etj, e cila përbën një kufizim të rëndësishëm të objektit të punës monitoruese dhe audituese.

Por pavarësisht mungesës se komunikimit dhe të informacioneve që duhet të jepte subjekti politik ne vazhduam procesin e monitorimit në terren për përmbushjen e objektit të parë të kontratës, kryerjen e monitorimit të shpenzimeve të fushatës zgjedhore.

Siç është përshkruar dhe në raportin e hartuar për këtë çështje, nga monitorimi në terren i aktivitetit elektoral, është konstatuar se Partia G99, nuk ka zhvilluar asnjë aktivite elektoral dhe nuk ka siguruar të ardhura dhe kryer shpenzime për fushatën zgjedhore. Po ashtu, për shkak të moskomunikimit, ne nuk mundëm të siguronim evidencë për transaksione financiare të kryera gjatë periudhes së fushatës.

Në kushtet e mungesës së plotë të dokumenteve dhe transaksioneve, për të ardhurat dhe shpenzimet që lidhen me fushatën zgjedhore, dhe kufizimeve të shpjeguara më lart, objekti i kontratës për "Kryerjen e auditimit ligjor të detyrueshëm të fondeve të përfituara dhe të shpenzuara gjatë fushatës zgjedhore, për zgjedhjet në Organet e Qeverisjes Vendore të datës 30.06.2019, nga Partia G99", nuk është realizuar.

Faleminderit për mirkuptimin.

**Audituesi Ligjor(Ekspert Kontabël i Regjistruar)**

(firma)

**Afrim Suli**